

Sot më 03 shtator 2021, vendoset themelimi i shoqërisë "Euro Academy News" SHPK.

AKT – THEMELIMI
I
SHOQËRISË

"Euro Academy News" SHPK

1. EMRI DHE FORMA LIGJORE E SHOQËRISË

- 1.1 Emri i shoqërisë do të jetë **"Euro Academy News" SHPK**, nga këtu e mëposhtë referuar si "shoqëria". Shoqëria është e organizuar si shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar (SHPK).

2. ORTAKËT E SHOQËRISË

- 2.1 Shoqëria është themeluar nga dy ortakët:


- **"Inter Media Group" SH.P.K**, shoqëri tregtare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L61429018R dhe me adresë të selisë qendrore në: Rr. "Rezervat e Shtetit", Lundër 1, Farkë, Tiranë, e përfaqësuar nga Administratori **Z. Theodhoro Çami**.

dhe,

- **Zj. Karolina Rista**, shtetase shqiptare, lindur në Durrës dhe banues në Tiranë, e datëlindjes 05.04.1979, identifikuar nga Letërnyoftimi me Nr. Personal H95405200G dhe banuese në adresën: Rr. "Konferenca e Pezës", Pll. Golloborda, Shk.2, Ap.25, Tiranë.

3. SELIA E SHOQËRISË

- 3.1 Shoqëria ka selinë e saj në adresën: **Rruga e "Rezervave të Shtetit" Lundër 1, Farkë, Pasuria me Nr. 590/1/14, Z.K. 2529, Tiranë, Shqipëri.**
- 3.2 Shoqëria mundet të shtrijë aktivitetin e vetë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo mundet të themelojë degë, ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë tij.
- 3.3 Selia e shoqërisë mundet të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.



4. OBJEKTI I AKTIVITETIT

4.1 Shoqëria mund të kryejë në Republikën e Shqipërisë, çdo aktivitet që nuk ndalohe nga ligji në fuqi, të tillë si, por pa u kufizuar në:

- *Ushtrimi aktivitetit të krijimit, administrimit të një strukture mësimore didaktike me qëllim prodhimin, kualifikimin e stafëve elitare të gazetarisë, medias dhe televizionit, duke përfshirë kurse trajnimi dhe kualifikime për të gjitha profileve e punës në këto fusha,*
- *Ushtrimi aktivitetit të arsimit plotësues pas Universitar të gazetarëve dhe reporterëve;*
- *Ushtrimi aktivitetit të trajnimeve të avancuara për marrjen, përpunimin, selektimin dhe përhapjen e informacionit publikut nëpërmjet medias online, televizione dhe medias së shkruar;*
- *Ushtrimi aktivitetit të trajnimeve në fushën e inovacionit dhe teknologjisë së informacionit, programeve të ndryshme aplikative, software/hardware të cilat përdoren në fushën e gazetarisë, mediave dhe televizionit*
- *Ushtrimi aktivitetit të trajnimeve për rritjen e kapaciteteve menaxhuese e profesionale të enteve të ndryshme publike dhe private (Administratë publike, Korporata, SME, OJF e individë) që veprojnë në fushën e gazetarisë, medias, televizionit etj;*
- *Ushtrimi aktivitetit të trajnimeve të target-grupeve të veçanta si studentë, punonjës të gazetarisë dhe mediave, të shërbimeve të montazhit televiziv, kameramanë, teknik studio, etj., në kuadrin e edukimit të vazhdueshëm;*
- *Ushtrimi aktivitetit të shërbimeve të tjera si konsulentë mediatik, autor programacioni, teknik audio-video, organizim eventesh të ndryshme si konferenca, workshop/ seminare, etj.*
- *Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.*

5. PERIUDHA E AKTIVITETIT

5.1 Periudha e aktivitetit të shoqërisë është **me afat të pacaktuar**, afat që fillon nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).


5.2 Çdo ndryshim në lidhje me periudhën e aktivitetit mundet të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

6. KAPITALI THEMELTAR

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **100,000 (një qind mijë) lekë**

6.2 Kapitali themeltar është ndarë në **2 (dy) kuota** .

6.3 Kapitali përbëhet nga 2 (dy) kuota të cilat zotërohen:



- 70 % (shtatëdhjetë përqind) nga Ortaku “Inter Media Group” SH.P.K dhe
- 30 % (tridhjetë përqind) nga Ortaku Zj. Karolina Rista.

7. ORGANET VENDIMARRËSE TË SHOQËRISË

7.1 Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- a. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- b. Administratori.

8. ADMINISTRATORI

8.1 Administratori i parë i shoqërisë është: **Zj. Karolina Rista**, shtetase shqiptare, lindur në Durrës dhe banues në Tiranë, e datëlindjes 05.04.1979, identifikuar nga Letërnjoftimi me Nr. Personal H95405200G dhe banuese në adresën: Rr. “Konferenca e Pezës”, Pll. Golloborda, Shk.2, Ap.25, Tiranë.

8.2 Mënyra e emërimit, e shkarkimit, të drejtat dhe detyrimet e administratorit, si dhe koha e qëndrimit në detyrë të saj përcaktohen në Statut dhe në ligj.

9. PASQYRAT FINANCIARE, KONTABILITETI DHE MBYLLJA (LIKUIDIMI) I SHOQËRISË

9.1 Pasqyrat financiare vjetore, përfshirë bilancin, dhe deklaratat do të përgatiten sipas legjislacionit shqiptar dhe për sa kohë është e mundur atëherë kur ligji shqiptar lejon zgjedhjen e standardeve të ndryshme të kontabilitetit, në IFRS.

9.2 Librat kontabël do të mbahen në gjuhën shqipe dhe monedhën shqiptare si edhe në përputhje të plotë me ligjet dhe rregullat shqiptare të kontabilitetit.

9.3 Në rast të falimentimit të kompanisë, procesi i likuidimit do të realizohet në përputhje me procedurat ligjore në fuqi në momentin e falimentimit.

ORTAKËT

“Inter Media Group” SH.P.K

E Përfaqësuar nga Administratori

Z. Theodhoro Çami

Karolina Rista

